



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
ZYRA KRYETARIT

Nr. 11310/15 prot

Vlorë, më 17.12.2020

VENDIM

Nr. 6 Datë 17.12 2020

“MBI KRYERJEN E PROCEDURAVE LIGJORE, MIDIS BASHKISË VLORE DHE SHOQËRISË “MATERIA CONS.AL” SHPK, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKB VKB NR. 58, DATE 05.08.2020”

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“, neni 8, neni 9/1 pika 1/1 a dhe b, nenet 10, 23, 54/k; Ligjin Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 30 e vijues, VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores të zhvillimit të territorit”, VKB nr. 64, date 31.08.2017 “Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Vlore”; VKB nr. 58, date 05.08.2020 “Për miratimin e kritereve të përdorimit të intensitetit me kusht si instrument i zhvillimit të territorit”, VKB nr. 59, datë 05.08.2020 “Për disa saktësime dhe ndryshime në VKB nr. 60, datë 31.08.2017, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Vlorë”, VKB nr. 79, datë 28.10.2020 “Për disa shtesa dhe konfirmim të VKB nr. 59, datë 05.08.2020, miratimi nga KKT në mbledhjen e datës 03.12.2020, pika 3 në rendin e ditës “Dokumenti i rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë”, lejes së zhvillimit nr.424 datë 10.07.2019 të miratuar nga Bashkia Vlorë, kërkesës së paraqitur nga subjekti zhvillues “MATERIA CONS.AL” shpk, në Urdhri i Kryetarit të Bashkisë nr.271 datë datë 10.12.2020 me objekt “Për realizimin e programit të intensitetit të ndërtimit me kushte midis Bashkisë Vlorë dhe subjektit zhvillues “MATERIA CONS.AL”, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga grupi i punës,

V E N D O S :

1. Pranimin e kërkesës të shoqërisë “MATERIA CONS.AL” shpk me NIPT L02427001J, si dhe dokumentacionin e hartuar në funksion të saj, me objekt për zbatimin e programit të intensitetit të ndërtimit me kusht, si pasojë e zbatimit të lejes së zhvillimit nr.424 datë 10.07.2019 të miratuar nga Bashkia Vlorë, për në pasuritë me nr. pasurie 32/431, 32/562, 32/525, 32/574, 32/29-D, 32/, ZK 8604, në pronësi të: Alma dhe Petrit Xhema, Alesjo Gjinaj, familja Beqiri, Koci, Gjinaj, Engjell Aliaj, Fatmir Xhema, Myslym Aliaj, Ismail Aliaj, me sipërfaqe 1530 m2 dhe adresë LAGJA “1 MAJI“ BASHKIA VLORE

2. Të miratojë procedurat ligjore sipas përcaktimeve të nr. 58, date 05.08.2020 “Për miratimin e kriterëve të përdorimit të intensitetit me kusht si instrument i zhvillimit të territorit”, për negocimin me zhvilluesit privat që shprehin interesin të bashkëpunojnë me Bashkinë Vlorë nëpërmjet marrëveshjes të lidhur për zhvillimin e pronës së paluajtshme të parashikuar nga Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Vlorë.
3. Të miratojë akt marrëveshjen e lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe shoqërisë “MATERIA CONS.AL” shpk për efekt të vazhimit të procedurave të mëtejshme për miratimin e lejes së ndërtimit.
4. Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me grupin e punës të monitorojë zbatimin e marrëveshjes së lidhur sipas pikës 3 të vendimit dhe të drejtave e detyrimeve që rrjedhin prej saj.
5. Drejtoria Kontrollit, Planifikimit dhe Zhvillimit të përfundoj procedurën në përputhje me dispozitat e ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe akteve nënligjore në fuqi.



KRYETARI

Dritan LELI